



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 07 shtator 2020  
Nr. ref.:RK 1617/20

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI76/20**

Parashtrues

**Kujtim Zarari**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit AD.nr.01/2020  
të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të 5 shkurtit 2020,  
dhe Njoftimit AD.nr. 03/2020 të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit,  
të 25 shkurtit 2020**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

## **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kujtim Zarari, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston: a) Vendimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, AD.nr.01/2020, të 5 shkurtit 2020, të nënshkruar nga Zëvendës Kryeprokurori (në tekstin e mëtejme: Vendimi i Zëvendës Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore); dhe b) Njoftimit AD.nr. 03/2020, të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, të 25 shkurtit 2020 (në tekstin e mëtejme: Kryeprokurori i Shtetit).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon të jenë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 5 maj 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 28 prill 2020.
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese) Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 1 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzoj në Gjykatë i) formularin e kërkesës së Gjykatës, si dhe ii) ankesën e dorëzuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kundër Vendimit AD.nr.01/2020, të 05 shkurtit 2020
8. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Prokurorinë Themelore dhe Prokurorinë e Shtetit për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 10 qershor 2020, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës dokumentet e kërkuara.

10. Më 22 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

11. Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese dy kërkesa, gjegjësisht kërkesën KI 77/20, si dhe kërkesën aktuale KI 76/20. Në këto dy kërkesa parashtruesi konteston vendime dhe procedura të ndryshme, të natyrës penale dhe disiplinore, por që janë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Objekt i kërkesës në shqyrtim, KI 76/20, është procedura disiplinore, por për shkak të ndërlidhshmërisë së këtyre dy procedurave, Gjykata e konsideron të rëndësishme t'i paraqes të dyja.

### ***Procedura penale në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte palë në cilësinë e të dëmtuarit***

12. Parashtruesi i kërkesës është i punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjarë në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: QKMF).
13. Më 12 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës ishte sulmuar në objektin e QKMF-së nga personi M.Gj., po ashtu i punësuar në QKMF, me ç'rast parashtruesi i kërkesës kishte pësuar lëndime trupore.
14. Më 10 shtator 2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë kishte ngritur aktakuzë kundër personit M.Gj., për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor, sipas nenit 188, paragrafi 1, pika 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, të 13 korrikut 2012 (në tekstin e mëtejme: KPRK-së).
15. Më 7 nëntor 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit P.nr.621/18, shpalli fajtor personin M.Gj., për veprën penale lëndim i lehtë trupor sipas nenit 188, paragrafi 1, pika 1.4 të KPRK, duke i shqiptuar dënim me gjobë në një shumë të caktuar të hollash. Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata Themelore për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi parashtruesin e kërkesës (në cilësinë e palës së dëmtuar), në kontest civil.
16. Ndaj Aktgjykimi P.nr.621/18 të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe rikualifikimin e veprës penale, duke kërkuar që personit M.Gj., t'i shqiptohet dënim më i ashpër. Gjithashtu, Prokuroria e Apelit të Kosovës, përmes parashtrësës PPA/II nr. 1559/2019, kishte propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruesi të kërkesës lidhur me ashpërsimin e dënimit ndaj personit M.Gj.
17. Më 2 mars 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PA1.nr. 1547/2019, e refuzoi ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore P.nr.621/18.



18. Siç u sqarua më lartë, parashtruesi i kërkesës, ka kontestuar këtë procedurë në Gjykatë përmes kërkesës KI 77/20.

***Procedura disiplinore e iniciuar kundër prokurorit që kishte ngritur aktakuzë ndaj personit M.Gj.***

19. Më 30 dhjetor 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës nr.2265/2019, kishte paraqitur *“njoftimin-parashtresën e karakterit disiplinor”*, në Prokurorinë Themelore, sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës ndaj prokurorit të shtetit B.K.. Në këtë shkresë pretendohet se prokurori në fjalë, lidhur me aktakuzën për të cilën është zhvilluar procedura penale e lartcekur, ka bërë shkelje disiplinore dhe atë lidhur me cilësimin juridik të veprës për të cilën është akuzuar personi M.Gj. Kjo pasi aktakuza ndaj personit M.Gj., nuk reflekton pretendimet e parashtruesit të kërkesës si palë e dëmtuar, se personi M.Gj., me veprimet e tij ka konsumuar edhe veprën penale *“Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”*, sipas nenit 410 të KPRK-së, duke pasur përsysh që edhe parashtruesi i kërkesës edhe personi M.Gj., janë persona zyrtar dhe punonjës në të njëjtin institucion.
20. Më 5 shkurt 2020, Prokuroria Themelore, gjegjësisht Zëvendës Kryeprokurori i kësaj Prokurorie, përmes Vendimit AD.nr.01/2020, duke vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës si dhe qëndrimin e prokurorit të shtetit B.K., kishte konstatuar se në rastin konkret *“nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore”* të parashikuar me Ligjin nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (në tekstin e mëtejme: Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve) dhe, rrjedhimisht, nuk e kishte referuar rastin për fillimin e hetimeve në Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK).
21. Më 13 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës, kundër Vendimit AD.nr.01/2020 të Zëvendës Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, parashtoi ankesë në Prokurorinë e Shtetit, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Parashtruesi pretendonte se Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, mund të hedhë poshtë ankesën kur është *“qartazi e pabazuar”*, ose kur ankesa duket *“joserioze”*. Andaj, sipas parashtruesit, meqë Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore nuk e ka trajtuar çështjen si *“qartazi të pabazuar apo joserioze”*, ka pasur për detyrim të veproj në përputhje me nenin 12, paragrafi 2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, konkretisht që të kërkoj nga KPK që të filloj hetimet disiplinore ndaj prokurorit B.K.
22. Më 25 shkurt 2020, Prokuroria e Shtetit, përmes Njoftimit AD.nr.03/2020, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se *“Në rastin konkret disiplinor, [...], me dispozitën e nenit 15 par.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore [...] nuk parashihet mundësia ligjore që pala në këtë rast Ju, të ushtroni ankesë kundër vendimeve të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, por e drejta e ankesës i njihet palës vetëm ndaj vendimeve disiplinore të [KPK-së]. Pra në këtë rast meqenëse nuk kemi të bëjmë me ndonjë vendim disiplinor të marrur nga [KPK], por kemi të bëjmë me vendim të marrur në emër të kompetencave ligjore të*

*Kryeprokurorit te Prokurorisë Themelore, në këtë gjendje faktike ligjore nuk është e lejuar ankesa ndaj atij vendimi dhe se kemi të bëjmë me vendim përfundimtar.”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

23. Në kërkesën e tij (KI 76/20) parashtruesi konteston vendimet e marra në procedurën disiplinore të iniciuar kundër prokurorit të shtetit B.K., që kishte ngritur aktakuzë ndaj personit M.Gj., duke pretenduar se me vendimet e kontestuar janë bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
24. Lidhur me këtë, ai thekson se *“Prokuroria Themelore [...], duke vepruar në kundërshtim me procedurën ligjore të përcaktuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore [...], ka ndërmarrë procedurën hetimore dhe me pastaj ka zgjidhur në merita këtë çështje.”* Ai më tej shton se *“në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore [...], në nenin 9 par.6 të atij ligjit përcaktohet qartë se autoriteti kompetent, në rastin konkret Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore vetëm në rastet kur kërkesa është qartazi e pabazuar mund të e hudh poshtë ankesën ose kur ankesa duket joserioze. Në rastin konkret, prokuroria nuk ka hudh poshtë ankesë, por të njëjtën e ka zgjidhur në meritum.”*
25. Rrjedhimisht, ai pretendon se konform nenit 12, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, në rastin konkret, është dashur që të kërkoj nga KPK që të filloj hetimet disiplinore duke pas parasysh që ekziston dyshimi i bazuar se prokurori ndaj të cilit është ushtruar ankesë, ka kryer veprën e pretenduar.
26. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se, në cilësinë e të dëmtuarit në këtë çështje, atij i është shkelur statusi i barabartë i palës pasi personi M.Gj., gabimisht dhe në mospërputhje me gjendjen faktike akuzohet se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor edhe pse me dispozitivin e aktakuzës dhe veprimet e personit M.Gj., janë konsumuar elementët e veprës penale *“sulm ndaj personit zyrtar”* gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, nga neni 410 i KPRK-së.
27. Ai shton se lidhur me këtë parashtruesi i ishte drejtuar prokurorit të çështjes duke kërkuar që të ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale, por këto pretendime të tij nuk janë marrë parasysh nga prokurori në fjalë me arsyetimin se *“këtu kemi të bëjmë dy persona të punësuar në të njëjtën institucion që të dytë kanë statusin e personit zyrtar”*.
28. Andaj, parashtruesi lidhur me vendimet e kontestuar pretendon se *“Në bazë të Vendimit [të Zëvendës Kryeprokurorit të] Prokurorisë Themelore AD.nr. 01/2020 të dt. 05.02.2020 dhe të [Njoftimit] të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit AD.nr.03/20 të dt. 25.02.2020, parashtruesit të kërkesës i është mohuar e drejta në Ankesë, e cila e drejtë është e garantuar dhe e mbrojtur me nenin 32 [...] drejta në Mjete Juridike. Nuk mund të ketë vendim të një organi të shkallës së parë, me të cilën vendoste në meritum të çështjes dhe nuk i lejon palës të drejtën në Ankesë.”*



29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anuloj Vendimin e Zëvendës Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në, AD.nr.01/2020, të 5 shkurtit 2020; dhe Njoftimit e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit AD.nr. 03/2020, të 25 shkurtit 2020.

### **Dispozitat relevante ligjore**

### **Ligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve**

#### **“Neni 9**

Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore

1. *Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoritetet vijuese (në tekstin e mëtejme: “Autoriteti Kompetent”):*

*[...]*

- 1.5. *Kryeprokurori për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të prokurorëve të punësuar në prokurorinë për të cilën është përgjegjës Kryeprokurori.*

*[...]*

2. *Kur ankesa i dërgohet autoritetit jokompetent, autoriteti i tillë do të transferojë ankesën tek autoriteti kompetent, në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

3. *Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori tek Avokati i Popullit.*

*[...]*

6. *Autoriteti Kompetent sipas nenit 9, paragrafin 1, shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkuar. Lidhur me vendimin e marrë, Autoriteti Kompetent njofton menjëherë me shkrim personin që ka paraqitur ankesë. Një kopje e vendimit i dorëzohet edhe Këshillit përkatës, dhe në rastet e parapara me paragrafin 3 të këtij neni edhe Avokatit të Popullit.*

*[...]*

#### **Neni 12**

#### **Procedura hetimore**

1. *Këshilli fillon procedurat disiplinore mbi bazën e kërkesës të dorëzuar në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të këtij Ligji.*

2. *Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.*

*[...]*

Neni 15  
Ankesa ndaj vendimeve disiplinore

1. *Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.”*  
[...]

**Pranueshmëria e kërkesës**

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:  
  
*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*  
[...]  
*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
32. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

- “1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.



*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

33. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor.

34. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

35. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, gjegjësisht të drejtës për mjete juridike të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, që përcakton se:

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

36. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore nuk ka për obligim që të kërkoj nga KPK të filloj hetimet ndaj prokurorëve vetëm nëse konstaton se kërkesa është “qartazi e pabazuar” ose “joserioze”. Por, sipas tij, në rastin konkret pasi Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore nuk e ka hedhur poshtë rastin si qartazi të pabazuar apo joserioz, sipas nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka pasur obligim që të kërkoj nga KPK të filloj hetimet lidhur me shkelje disiplinore nga prokurori B.K. Andaj, ai pretendon se atij i është mohuar e drejta për mjete juridike e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, pasi Zëvendës Kryeprokurori, në kundërshtim me Ligjin për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nuk ka kërkuar nga KPK të filloj hetimet disiplinore ndaj prokurorit B.K.

37. Gjykata rikujton edhe një herë se neni 32 i Kushtetutës garanton të drejtën për të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij, por thekson se kjo duhet të bëhet në “mënyrën e përcaktuar me ligj.”

38. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet nenit 9 [Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore], të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, që përcakton se Autoriteti kompetent, në këtë rast



Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, *“shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12, paragrafin 2, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje, disiplinore, ose është parashkruar”*.

39. Ndërsa neni 12, paragrafi 2 i Ligjit të lartcekur parasheh se *“Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.”*
40. Gjykata vëren se sipas dispozitave të lartcekura, rasti nuk duhet të procedohet para KPK-së për fillimin e hetimeve disiplinore nëse Autoriteti Kompetent, në këtë rast Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, vlerëson se: a) ankesa është dukshëm joserioze; b) e pabazuar; c) nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore; ose d) është parashkruar. Në këtë rast, vendimi i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore është përfundimtar pasi në Ligjin për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nuk parashihet mundësi ankese.
41. Andaj, njëra nga arsyet për të cilat Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore mund të mos kërkoj nga KPK që të zhvillohen hetimet, ashtu si u sqarua më lart, është edhe rasti kur ai/a jo konstaton se ankesa *“nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore”*.
42. Në këtë aspekt, ankesa e parashtruesit të kërkesës ndaj prokurorit të shtetit B.K., ishte adresuar përmes Vendimit AD.nr.01/2020 të Zëvendës Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, i cili pasi kishte vlerësuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës si dhe qëndrimin e prokurorit të shtetit B.K., kishte sqaruar se: *“Duke u bazuar në provat e paraqitura në shkresat e lëndës ku kemi vetëm një raport mjekësor dhe duke u bazuar në pranimin e fajësisë, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do përsëris veprën e tillë, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit për lëndimet e marra, sjelljen e tij korrekte para gjykatës, pasi që për herë të parë ndeshet me ligjin, shqiptimi i dënimit me gjobë mendoj se është adekuat në këtë rast andaj edhe nuk e kame parë të arsyeshme se në këtë rast të bëjë ankese në Gjykatën e Apelit sa i përket lartësisë së dënimit. Duke marr për bazë se kjo lëndë me ankesën e të dëmtuarit gjendet në Gjykatën e Apelit, nëse unë si Prokuror kam gabuar në kualifikimin e veprës penale apo Gjykata ka dhënë dënim jo meritor do të vendos Gjykata e Apelit e cila ende nuk ka vendosur lidhur me këtë lëndë”*. Rrjedhimisht, Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore vendosi që në rastin konkret *“nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore”* të parashikuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe rrjedhimisht nuk e kishte referuar rastin për fillimin e hetimeve në KPK.
43. Ndërsa Prokuroria e Shtetit, përmes Njoftimit AD.nr.03/2020, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se *“sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve(Ligji. nr. 061L-057), nuk parashihet mundësia ligjore që pala, të ushtroni ankesë kundër vendimeve të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, por e drejta e ankesës i njihet palës vetëm ndaj*



*vendimeve disiplinore të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Pra ne këtë rast meqenëse nuk kemi të bëjmë me ndonjë vendim disiplinor të marrur nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, por kemi të bëjmë me vendim të marrur në emër të kompetencave ligjore të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, ne këtë gjendje faktike ligjore nuk është e lejuar ankesa ndaj atij vendimi dhe se kemi të bëjmë me vendim përfundimtar të Prokurorisë Themelore.*

44. Rrjedhimisht, pretendimi i parashtruesit të kërkesës se sipas Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Zëvendës Kryeprokurori, pasi nuk e ka hedhur poshtë ankesën ose si “qartazi të pabazuar” ose si “joserioze”, ka pasur për obligim që të kërkojë fillimin e hetimeve ndaj prokurorit B.K, nga KPK-së, nuk është i bazuar.
45. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se efikasiteti i mjeteve juridike të parapara me nenin 32 të Kushtetutës, në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, nuk përcaktohet në bazë të asaj nëse parashtruesi i kërkesës me shfrytëzimin e tyre ka arritur t’i realizojë qëllimet e tij në mënyrën se si ai kishte synuar, por nëse ai kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai e shfrytëzon të mund të paraqesë argumentet e tij që do të shqyrtohen nga autoritetet kompetente (shih rastin e GJEDNJ-së *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 120).
46. Për më tepër, Gjykata thekson se sipas praktikës së GJEDNJ, megjithëse secili ka të drejtë për të përdorur mjetet juridike kundër vendimeve administrative dhe gjyqësore, KEDNJ nuk e garanton të drejtën e ankesës nëse atë nuk e parashihet legjislacioni vendor (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Darnay kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 36524/97, Vendim i 16 prillit 1998).
47. Gjykata vëren se në rastin konkret, Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore dhe Prokuroria e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi kanë vlerësuar faktet dhe kanë interpretuar dhe zbatuar dispozitat ligjore në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Pasi Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore ka ardhur në përfundim se në rastin e ankesës së parashtruesit të paraqitur përmes Avokatit të Popullit “nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje disiplinore” të parashikuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në pajtim me atë Ligj nuk e kishte referuar rastin për fillimin e hetimeve në KPK. Gjithashtu, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte konstatuar, po ashtu duke u bazuar në Ligjin për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve se meqenëse nuk kemi të bëjmë me ndonjë vendim disiplinor të marrur nga KPK, por kemi të bëjmë me vendim të marrur në emër të kompetencave ligjore të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, sipas Ligjit të lartcekur nuk është e lejuar ankesa ndaj atij vendimi dhe se kemi të bëjmë me vendim përfundimtar të Prokurorisë Themelore.
48. Më tutje, Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi, ashtu si kërkohet me Ligjin për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në harmoni me nenin 32 të Kushtetutës, të paraqes rastin e tij, sa i përket ankesave të tij për shkelje disiplinore nga prokurori i rasti B.K., para Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Ankesa e tij, e dorëzuar përmes Avokatit të Popullit, ishte shqyrtuar nga Zëvendës Kryeprokurori i Prokurorisë



Themelore, i cili ka vepruar sipas kompetencave të parapara me Ligjin për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Këtë rast, parashtuesi i kërkesës e kishte referuar dhe tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Gjykata vëren se vendimi i Zëvendës Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore e po ashtu edhe vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit u morën pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtuesi i kërkesës.

49. Gjykata më tej vëren se parashtuesi i kërkesës përsërit para Gjykatës të njëjtat argumente që kishte parashtuar në procedurat pranë Prokurorisë së Shtetit, në veçanti lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërisë së vendimit të Zëvendës Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.
50. Në lidhje me këtë, Gjykata dëshiron të vë theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, apo instancat tjera përkatëse, gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtuesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 55; shih gjithashtu rastin KI40/17 Parashtues *Muharrem Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 korrikut 2017, paragrafi 35).
51. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI129/19, parashtuesi i kërkesës: *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 56 dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtuesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012, paragrafi 33).
52. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimet se procedurat e zhvilluara në Prokurorinë Themelore të Gjakovës dhe tek Kryeprokurori i Shtetit, në ndonjë mënyrë, kanë shkaktuar shkelje të të drejtës së tij për mjete juridike, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës.
53. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 22 korrik 2020, njëzëri

## VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Bekim Sejdiu



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi